# Raporti i Derrogimeve_Kodi i Rrjetit, Kodi i Matjes

Qershor 2013

| Nr. | Kodi i Rrjetit | Neni | Paragrafi | Periudha e Derogimit e kërkuar (në vite/muaj) | Periudha e Derogimit e lejuar (në vite/muaj) | Periudha deri kur vlen Derogimi | Arsyeja e Kërkesës për Derogim |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **1.** | **Kodi i Planifikimit Operativ** | **3.4.3 Pengesat e Sistemit të transmisionit** | 3.4.3.1 | 6 muaj | **6 muaj** | **31.12.2013** | Parashikimet e pengesave në sistemin e transmisionit nuk bëhen sipas versionit aktual 2.1 të Kodit të Rrjetit për këto arsye:<br>1. Për tri pikat e para janë bërë propozime për amendamentimin në versionin 2.2 (i cili aktualisht është në shqyrtim në ZRrE). Kërkohet derogim derisa të aprovohen ndryshimet në versionin e propozuar 2.2.<br>2. Për shkak të pengesave që dalin nga mos-anëtarësimi në ENTSO-E, KOSTT ende nuk ka qasje në DACF-platformën rajonale, për këtë arsye pika e fundit nuk mund të plotësohet. |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | **3.5 Informacioni që duhet dhënë OSTT**<br><br>**3.5.2 Mujore** | 3.5.2.2 | 6 muaj | **6 muaj** | **31.12.2013** | Data dhe ora e parashikimeve të minimumeve dhe maksimumeve të ngarkesës nuk mund të publikohet, prandaj kërkohet derogim vetëm për publikim derisa të mundësohet që kjo të paraqitet në platformën e web faqes së KOSTT. |
| | | **3.11 Vlerësimi i Sigurisë**<br><br>**3.11.2 Procesi** | 3.11.2.1 | 6 muaj | **6 muaj** | **31.12.2013** | Publikimi i vlerësimeve afatgjata dhe afatmesme të sigurisë së sistemit të transmisionit nuk bëhet, prandaj kërkohet derogim vetëm për publikim. |
| | | **3.12 Vlerësimet e Sigurisë së Sistemit Energjetik (PSSA-të)**<br><br>**3.12.3 PSSA javore** | 3.12.3.3 | 6 muaj | **6 muaj** | **31.12.2013** | Të gjitha kërkesat e cekura në këtë dispozitë kryhen përveç publikimit, prandaj kërkohet derogim vetëm për publikim. |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **2.** | **Kodi i Balancit** | **2.4.3 Dispeçimi në kohë reale** | 2.4.3.5 | 1 vit | **1 vit** | **30.06.2014** | Bazuar në Rregullat e Tregut të propozuara, OST do të shes ose blejë energji nga Palët Tregtare për nevoja të liferimit të Programit të Kompensimit duke shfrytëzuar Kontratën e Shërbimeve Ndihmëse standarde (paragrafi 13.2.5 i Rregullave të Tregut).<br>Meqë këto rregulla nuk janë aprovuar ende, devijimet e paqëllimshme menaxhohen me plane javore të kompenzimit në koordinim me qendrën e bllokut rregullues. Edhe nëse në një të ardhme të afërt aprovohen Rregullat e Tregut (të propozuara) do të nevojitet edhe një kohë për implementim të kësaj dispozite! |

| Nr. | Kodi | Neni | Paragrafi | Periudha e Derogimit e kërkuar(në vite/muaj) | Periudha e Derogimit e Lejuar (në vite/muaj) | Periudha deri kur vlen Derogimi | Arsyeja e Kërkesës për Derogim |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **1.** | **Kodi i Matjes** | **8.2 Matjet e Kapacitetit (Fuqisë) dhe Energjisë** | 8.2.1.6 | 1. 1 vit<br>2. 6 muaj<br>3. 2 vjet<br>4. 14 muaj<br>5. 2 vite<br>6. 2 vite<br>**7. 2 vite** | 1. 1 vit<br>2. 6 muaj<br>3. 1 vit<br>4. 1 vit<br>5. 1 vit<br>**6. 1 vit**<br>**7. 1 vit** | 01.11.2008<br>01.05.2009<br>01.05.2010<br>30.06.2011<br>30.06.2012<br>**30.06.2013**<br>**30.06.2014** | Duhet të instalohen transformatorët matës me dy bërthama. Aktualisht në të gjitha linjat interkonektive 400 kV, 220 kV dhe 110 kV si dhe me NS Vallaq, NS Zubin Potok dhe me HC Ujmani janë me një bërthamë. Grupet matëse në HC Ujmani janë të vendosura në nivelin e tensionit 6.3 kV që nuk janë në kufirin e përcaktuar ndarës.<br>Poashtu bazuar në vendimin e Qeverisë për çvendosjen e kufirit ndarës KOSTT-KEK nga niveli i tensionit 110kV në ate 35 dhe 10kV të gjitha Grupet Matëse të përfshira në Tabelën nr.2 të Raportit mbi Mangësitë e Grupeve Matëse (*e cila ju është dërguar me shkresën nr. 54 të datës 29 Janar 2013*) 35 trafofusha në nivelin 10 kV dhe 26 trafofusha në nivelin 35 kV nuk i plotësojnë kërkesat nga Kodi i Matjes. Këto mangësi do të eliminohen me implementimin e projektit për adaptimin e Grupeve Matëse i cili është në procedurë të përgatitjes së dokumentacionit për tenderim. |

Fund i Raportit